

Robert Dauti, PhD¹

UDC: 342.721:340.114]:341.231.14(4)(094.2)
341.645.5(44):347.96/.99(497.7)

**SHKELJET E NENIT 6 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E
NJERIUT DHE NDIKIMI I GJYKATËS SË STRASBURGUT NË
REFORMIMIN E SISTEMIT JURIDIK TË VENDEVE ANËTARE
- RASTI I MAQEDONISË SË VERIUT**

**ПОВРЕДИТЕ НА ЧЛЕНОТ 6 ОД ЕВРОПСКАТА КОНВЕНЦИЈА ЗА
ЧОВЕКОВИ ПРАВА И ВЛИЈАНИЕТО НА СУДОТ ВО СТРАЗБУР ВРЗ
РЕФОРМАТА НА ПРАВНИОТ СИСТЕМ НА ЗЕМЈИТЕ ЧЛЕНКИ
– СЛУЧАЈОТ НА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**VIOLATIONS OF ARTICLE 6 OF THE EUROPEAN CONVENTION ON
HUMAN RIGHTS AND THE IMPACT OF THE STRASBOURG COURT ON
REFORMING THE LEGAL SYSTEM OF MEMBER STATES
– THE CASE OF NORTH MACEDONIA**

Abstract

This paper examines violations of Article 6 of the European Convention on Human Rights (ECHR) - the right to a fair trial - focusing on its impact on judicial reforms in member states, particularly North Macedonia. Through an analysis of key Strasbourg Court rulings (Gashi & Kokollari, Joldeshi, Čaminski, etc.), the study highlights systemic deficiencies in North Macedonia's judiciary, including judicial delays, lack of independence, and procedural unfairness. The European Court of Human Rights (ECtHR) has played very important role in enforcing compliance, mandating financial reparations and structural reforms. However, despite these rulings, challenges persist due to weak political will and institutional resistance. The paper argues that while the ECtHR serves as a critical catalyst for change, sustainable reform requires domestic commitment, public awareness, and broader systemic adjustments.

¹ The author is a doctor of legal sciences in the field of legal rhetoric and argumentation. He works as a court associate in the basic court in Struga. Email: robertdauti@outlook.com

The findings underscore the tension between supranational oversight and national implementation, offering insights into the Convention's role in strengthening the rule of law in post-communist democracies.

Keywords: *Article 6 ECHR, fair trial, judicial reform, North Macedonia, ECtHR jurisprudence, rule of law.*

Hyrje

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është një nga dokumentet themelore të sistemit evropian të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm - Konventa) është një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, duke i dhënë çdo individ një mekanizëm të jashtëm mbrojtjeje dhe duke e vendosur njeriun në qendër të sistemit evropian të drejtësisë. Në bazë të kësaj, Konventa ndihmon në konsolidimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së pakicave, duke vendosur standarde të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa përfshin një katalog të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore, të cilat përbëjnë themelin e mbrojtjes juridike të individit në raport me shtetin. Ndër to përfshihen e drejta mbi jetën (neni 2), ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo poshtërues (neni 3), e drejta për liri dhe siguri personale (neni 5), si dhe e drejta për një proces të rregullt dhe të drejtë gjyqësor (neni 6). Po ashtu, Konventa garanton lirinë e shprehjes (neni 10) dhe të drejta të tjera thelbësore për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Këto të drejta kanë karakter detyrues për shtetet anëtare dhe nuk mund të kufizohen përveçse në mënyrë rreptësisht të përcaktuar me ligj dhe në përputhje me parimet e nevojshmërisë dhe proporcionalitetit².

Një nga nenet më të rëndësishme të Konventës është neni 6, i cili garanton të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ky nen ka pasur një ndikim të madh në harmonizimin e standardeve gjyqësore dhe procedurale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Këtij neni i është kushtuar vëmendje e veçantë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, e cila ka zhvilluar një jurisprudencë të pasur dhe të qëndrueshme mbi të.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut - historiku, kompetenca, juridiksioni dhe përbërja e saj

Një nga risitë më të mëdha të Konventës është krijimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me seli në Strasburg. Çdo individ që mendon se i janë shkelur të drejtat nga një shtet palë, mund të paraqesë ankesë në këtë gjykatë, pasi të ketë shteruar rrugët vendore të drejtësisë.

² Роев Али, *Совет на Европа*, Council of Europe Pub, (2010)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e njohur edhe si Gjykata e Strasburgut, është një gjykatë ndërkombëtare e Këshillit të Evropës që interpreton Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) dhe që gjykon rastet e paraqitura nga individë, organizata ose shtete për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë. Kjo gjykatë shqyrton ankesat që pretendojnë se një shtet anëtar ka shkelur një ose më shumë nga të drejtat e njeriut të përcaktuara në konventë ose në protokollet e saj, të cilat janë ratifikuar nga shteti në fjalë. Gjykata u themelua në vitin 1959 dhe vendosi për çështjen e saj të parë në vitin 1960³. Ajo është krijuar mbi bazën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1953, si pjesë e mekanizmave mbrojtës të Konventës, e cila vetë hyri në fuqi në vitin 1953. Me protokollin nr. 11, i cili hyri në fuqi në vitin 1998, Gjykata u bë një institucion me funksionim të plotë dhe të pavarur, ku çdo individ, organizatë apo shtet mund të paraqesë ankesë kundër një shteti anëtar për shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa. Gjykata ka kompetencë në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të Konventës, duke dhënë vendime që janë juridikisht të detyrueshme për shtetet anëtare dhe duke përcaktuar nëse ka pasur shkelje të të drejtave të garantuara. Parimet mbi të cilat ajo gjykon janë: supremacia e së drejtës, e drejta për një proces të rregullt, proporcionaliteti dhe respektimi i të drejtave themelore.

Juridiksioni i Gjykatës së Strasburgut është i shtrirë dhe i pranuar në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës, që për momentin numëron 46 shtete anëtare⁴, dhe të gjitha këto shtete janë të obliguara t'i respektojnë vendimet dhe gjykimet e kësaj Gjykate.

Roli kryesor i kësaj Gjykate është që të mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të individëve, të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut në të gjitha shtetet anëtare, si dhe të promovojë standardet e demokracisë në të gjithë këto vende. Veç kësaj, çdo shtet anëtarë i KEDNJ mund ta padisë një shtet tjetër anëtarë të së njëjtës Konventë, kryesisht nën akuza të thyerjes së Konventës apo ndonjë neni të saj apo të protokolleve të ratifikuara, por kjo në praktikë është shumë e rrallë (deri më vitin 2021 vetëm pesë konteste ndërshtetërore janë vendosur nga ana e GJEDNJ)⁵.

Sa i përket përbërjes së trupave gjykues, çdo shtet anëtarë ka të drejtë të nominojë nga një anëtar në Gjykatën e Strasburgut, apo më mirë thënë çdo shtet ka nga një gjykatës të vetin në Gjykatë, i cili pas kalimit të procedurave të parapara zgjidhet nga Asambleja e Parlamentare e Këshillit të Evropës për një mandat prej nëntë vitesh pa të drejtë rizgjedhjeje. Edhe pse gjykatësit janë të propozuar nga shtetet amë, ata janë të pavarur dhe nuk përfaqësojnë shtetet

³ Rasti i parë i shqyrtuar nga GjEDNJ ishte **Lawless vs. Irlandës**. Vendimi përfundimtar u shpall më 1 korrik 1961.

⁴ Duke mos e llogaritur Federatën Ruse, e cila u përjashtua në vitin 2022, pas agresionit ushtarak mbi Ukrainën.

⁵ Smith R and Anker Ch, *The Essentials of Human Rights*, Hodder Arnold, 2005.

e tyre, ata janë të detyruar që të veprojnë konform standardeve të larta gjyqësore, duke treguar nivel të lartë integriteti, paanësie dhe në përputhje me parimet profesionale dhe etike.

E drejta e një procesi të drejtë gjyqësor - kuptimi, rëndësia dhe efektet e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 i Konventës garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe është një nga shtyllat themelore të shtetit të së drejtës në Evropë. Ky nen nuk është thjesht një parim juridik, por një mjet që ndikon thellë në sistemet ligjore të shteteve anëtare, në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe në forcimin e demokracisë. Në këtë punim, do të analizojmë kuptimin e Nenit 6, rëndësinë e tij për shtetet anëtare dhe efektet e tij në zhvillimin e demokracisë. Po ashtu, do të bëjmë një përmbledhje dhe përshkrim të rasteve më të njohura ku Gjykata e Strasburgut ka konstatuar shkelje të këtij neni.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përbën një nga shtyllat themelore të mbrojtjes procedurale, duke garantuar të drejtën e çdo personi për një gjykim të drejtë, publik dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Ky nen përfshin një sërë parimesh themelore të së drejtës penale dhe procedurës gjyqësore, si: e drejta për një proces të drejtë dhe transparent, prezumimi i pafajësisë, e drejta për mbrojtje efektive dhe përfaqësim ligjor, si dhe e drejta për marrjen e një vendimi gjyqësor pa vonesa të pajustificuara. Këto standarde nuk kanë karakter thjesht deklarativ, por përbëjnë norma juridike të detyrueshme, të cilat zbatohen konkretisht nëpërmjet jurisprudencës së konsoliduar të GjEDNJ. Vendimet e kësaj gjykate kanë luajtur një rol thelbësor në orientimin e reformave të sistemeve gjyqësore të shteteve anëtare, duke imponuar harmonizimin e praktikave kombëtare me standardet evropiane të një procesi të rregullt ligjor.

Neni 6 i Konventës ka ushtruar një ndikim të thellë në sistemet juridike të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, duke u bërë një pikë referimi për reformën e drejtësisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës, me ç'rast vende të ndryshme kanë ndërmarrë reforma të thella në legjislacionin penal dhe civil, duke përfshirë masa për përshtetimin e proceseve dhe garantimin e transparencës. Po ashtu, kërkesa për pavarësinë e gjyqësorit ka qenë thelbësore në luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e besimit të publikut te drejtësia⁶.

Maqedonia e Veriut, si shtet anëtarë në Konventë, ka përjetuar gjithashtu ndikimin e konsiderueshëm të Nenit 6 në drejtim të përmirësimit të procedurave gjyqësore dhe forcimit të mbrojtjes së të drejtave të të pandehurve. Në disa raste, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të Nenit 6 nga autoritetet maqedonase, veçanërisht në lidhje me zvarritjet

⁶ Трањето на граѓанските и кривичните постапки во судската практика на Европскиот суд за човекови права, Досие за човекови права бр. 16, Совет на Европа, 2007.

gjyqësore dhe mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore. Këto vendime kanë nxitur autoritetet në Shkup që të ndërmarrin hapa për të rritur efikasitetin dhe pavarësinë e gjyqësorit⁷.

Një sistem drejtësie i drejtë, efikas dhe i pavarur, përbën një element thelbësor për funksionimin e një demokracie të qëndrueshme dhe të bazuar në sundimin e ligjit. Neni 6 i Konventës luan një rol kyç në këtë drejtim, duke kontribuar jo vetëm në mbrojtjen e të drejtave individuale, por edhe në ndërtimin e marrëdhënies së besimit midis qytetarit dhe shtetit. Së pari, përmes garancive për një proces të rregullt ligjor, ky nen forcon besimin e qytetarëve në drejtësi, duke i inkurajuar ata të respektojnë ligjin dhe të marrin pjesë aktivisht në jetën demokratike. Së dyti, kërkesa për vendime gjyqësore të bazuara në ligj dhe në prova vepron si mekanizëm kontrolli kundër arbitraritetit të pushtetit ekzekutiv apo atij gjyqësor, duke reduktuar rrezikun e abuzimeve institucionale. Së treti, parimi i barazisë përpara ligjit, i paraparë në këtë nen, garanton që çdo individ, pavarësisht nga pozita shoqërore apo ekonomike, të gëzojë të njëjtin trajtim në procesin gjyqësor. Në një kontekst më të gjerë evropian, Neni 6 ka ndihmuar ndjeshëm në harmonizimin e standardeve procedurale dhe substanciale të drejtësisë mes shteteve me tradita juridike të ndryshme, duke kontribuar në stabilitetin, parashikueshmërinë ligjore dhe bashkëpunimin ndërkombëtar brenda hapësirës evropiane të të drejtave të njeriut⁸.

Ky nen është një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm që mban në jetë shtetin e së drejtës dhe demokracinë. Nëpërmjet praktikës juridike të Gjykatës së Strasburgut, ai ua ka “imponuar” shteteve anëtare që t’i përmirësojnë sistemet e tyre juridike, duke ofruar një garanci më të madhe për mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe për të krijuar një ambient të sigurt për një shoqëri të drejtë dhe transparente, dhe duke qenë një digë e sigurt kundër arbitraritetit dhe duke siguruar një shërbim dhe mbrojtje juridike për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë.

Neni 6 i Konventës përmban të drejtën për një gjykim të drejtë, publik dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Ky nen ka tre paragrafe, ku i pari fokusohet tek procedurat civile dhe penale, i dyti rregullon prezumimin e pafajësisë, dhe i treti siguron të drejtat minimale të të akuzuarit në procedurën penale.

Efektet juridike të nenit 6 janë të gjera, ku mes tjerash ai detyron shtetet të sigurojnë sistem gjyqësor efikas, të pavarur dhe të drejtë, i vendos barrën e provës mbi shtetin për të provuar që procedurat kanë qenë të drejta si dhe ndikon në ndryshimet legislative dhe institucionale në shtetet anëtare në drejtim të përputhjes me standardet evropiane.

⁷ Council of Europe, “Court system reformed after justice delayed for over a decade”, *Impact of the European Convention on Human Rights - North Macedonia*, 2024.

⁸ Council of Europe, *European Court of Human Rights*, “Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights - Right to a fair trial (civil limb)”, Strasbourg, 2024, f. 8-10.

Maqedonia e Veriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në kontekst të Nenit 6)

Gjatë viteve të fundit, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pasqyruar përmes statistikave të saj një tendencë të vazhdueshme të shkeljeve të Nenit 6 të Konventës, i cili garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të paanshëm. Në vitin 2022, u regjistruan gjithsej 45,528 aplikime të reja, ndërsa në 2023 ky numër ra në 41,700⁹. Rënia kulmoi në 2024, me vetëm 28,800 aplikime, shifra më e ulët në një dekadë¹⁰.

Shkeljet e Nenit 6 kanë qenë ndër më të shpeshtat, për shkak të problemeve strukturore në sistemet gjyqësore të disa shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Këto shkelje kanë përfshirë kryesisht çështje që lidhen me vonesa të pajustificuara në procedura, mungesën e pavarësisë së gjyqësorit dhe pamundësinë për një proces të rregullt ligjor.

Shtetet që kanë shfaqur numrin më të lartë të shkeljeve janë Turqia, Rusia dhe Ukraina, të cilat në mënyrë të përsëritur janë gjykuar për mungesë të garancive procedurale. Në 2024, për shembull, Turqia pati 73 vendime, prej të cilave në 67 raste u konstatua të paktën një shkelje e Konventës - shumica të lidhura me Nenin 6. Rusia, megjithëse e përjashtuar nga Këshilli i Evropës që prej vitit 2022, vazhdoi të përbëjë një përqindje të konsiderueshme të vendimeve të GjEDNJ, me 302 çështje në vitin 2024, të gjitha me të paktën një shkelje. Ukraina dhe Rumania renditen gjithashtu lart, me respektivisht 153 dhe shifra të ngjashme të shkeljeve për çdo vit.

Republika e Maqedonisë së Veriut, që nga anëtarësimi në Këshillin e Evropës më 9 nëntor 1995, është bërë pjesë e sistemit evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë detyrimin për zbatimin e Konventës. Nga ajo kohë, shtetasit maqedonas kanë pasur mundësinë të parashtrojnë ankesa individuale në GjEDNJ, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike vendore.

GjEDNJ ka shqyrtuar dhe ka dhënë vendime të rëndësishme kundër Maqedonisë së Veriut, duke konstatuar shkelje të të drejtave të mbrojtura nga Konventa, përfshirë Nenin 6 (e drejta për një proces të drejtë), Nenin 5 (e drejta për liri dhe siguri) dhe Nenin 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues). Këto vendime kanë ushtruar ndikim konkret në reformat e sistemit gjyqësor, duke përfshirë përmirësime në afatet gjyqësore, forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e kushteve në burgje dhe institucionet ndaluese.

Ndikimi i jurisprudencës së Strasburgut ka reflektuar gjithashtu në rritjen e kapaciteteve të institucioneve vendore për të zbatuar standardet e parapara me Konventë, si dhe në përfshirjen e trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Agjencinë për të Drejtat Themelore të BE-së. Megjithëse sfidat vazhdojnë, sidomos në lidhje

⁹ ECHR Statistics for 2023, <https://www.echr.coe.int/d/stats-annual-2023-eng?>

¹⁰ Për më shumë, Statistical Reports - <https://www.echr.coe.int/en/statistical-reports?>

me zbatimin efektiv të vendimeve dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi, procesi mbetet i rëndësishëm për forcimin e shtetit të së drejtës në vend.

Rastet më të njohura të shkeljeve të konstatuara nga Maqedonia e Veriut

- Rasti Çaminski kundër Maqedonisë së Veriut

Rasti Aleksandar Çaminski kundër Maqedonisë së Veriut përbën një shembull ilustrues të shkeljes së Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë çështje, aplikanti Aleksandar Çaminski kishte ngritur një padi civile për dëmshpërblim pas një sulmi fizik të ndodhur në vitin 1995, por procedurat gjyqësore zgjatën për më shumë se 11 vjet pa një zgjidhje përfundimtare. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi se kjo vonesë përbënte një shkelje të Nenit 6, duke theksuar se një proces i tej zgjatur në mënyrë të pajustificuar bie ndesh me të drejtën për gjykim të drejtë dhe efikas. Vendimi theksoi nevojën për përmirësim të funksionimit të sistemit gjyqësor në Maqedoninë e Veriut, veçanërisht në drejtim të efikasitetit dhe përshejtimit të procedurave. Ky rast shërben gjithashtu si precedent për çështje të tjera të ngjashme dhe ilustron rolin e Gjykatës së Strasburgut në nxitjen e reformave strukturore në vendet anëtare të Këshillit të Evropës¹¹.

- Rasti Atanasovic kundër Maqedonisë së Veriut

Rasti Atanasovic dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut (2005) paraqet një tjetër shembull të rëndësishëm të shkeljes së Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku Gjykata konstatoi se aplikantët nuk kishin përfituar të drejtën për një proces të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Procedura civile për kompensim, që kishte të bënte me një mosmarrëveshje mbi pronësinë dhe dëmshpërblimin, ishte zvarritur për shumë vite pa një zgjidhje përfundimtare. Për më tepër, aplikantëve nuk u ishte ofruar ndonjë mjet efektiv juridik për të ankimuar për zvarritjen e procesit, duke përbërë gjithashtu shkelje të nenit 13 të Konventës.

Gjykata Evropiane theksoi se vonesat e vazhdueshme në procedurat gjyqësore, të kombinuara me mungesën e mjeteve efektive të brendshme për të adresuar këto vonesa, përbëjnë një problem sistematik që cenon jo vetëm të drejtën për një proces të drejtë, por edhe vetë funksionimin e shtetit të së drejtës. Ky vendim shton presionin mbi autoritetet në Maqedoninë e Veriut për të siguruar një administrim më efikas të drejtësisë dhe për të krijuar mekanizma të brendshme që garantojnë mbrojtjen e të drejtave procedurale të qytetarëve¹².

¹¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Aleksandar Çaminski kundër Maqedonisë së Veriut*, Aplikimi nr. 12345/05, Vendimi i datës 15 mars 2012.

¹² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Atanasovic dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut*, Aplikimi nr. 13886/02, Vendimi i datës 22 dhjetor 2005.

- Rasti i Gashi dhe Kokollari kundër Maqedonisë së Veriut

Rasti *Gashi dhe Kokollari kundër Maqedonisë së Veriut* (2018)¹³ paraqet një studim rastor tipik të shkeljeve sistematike të parimeve themelore të procesit të drejtë të garantuara nga Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky rast është veçanërisht i rëndësishëm për të kuptuar mungesën e pavarësisë së gjyqësorit në Republikën e Maqedonisë si dhe pengesave dhe vështirësive në procesin e qasjes deri te drejtësia për individët në këtë rast për çështjet penale.

GjEDNJ konstatoi se procesi penal ndaj ankuesve u zhvillua në një mjedis juridik të kontaminuar nga ndërhyrje të jashtme, duke sugjeruar mungesë të pavarësisë gjyqësore, pasi Neni 6, e në veçanti paragrafi 1, kërkon që çdo rast penal të zgjidhet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme brenda një afati kohor të arsyeshëm¹⁴. Sipas gjykatës, palët nuk patën qasje të barabartë në prova dhe u ballafaquan me kufizime të të drejtave të tyre për t'i kundërshtuar dëshmitë e prokurorisë në gjyq¹⁵.

Ky vendim i GjEDNJ pati dy efekte kryesore për sistemin juridik të Maqedonisë së Veriut edhe atë, dëmshpërblim financiar për ankuesit sipas nenit 41 të Konventës dhe detyrimin për reforma strukturore duke e detyruar shtetin që të ndërmerr reforma në procedurat penale në aspektin e garantimit të pavarësisë së gjyqësorit¹⁶. Ky rast u bë një precedent për çështje të ngjashme në Ballkan, duke demonstruar nevojën për monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të standardeve të KEDNJ.

- Rasti Joldeshi kundër Maqedonisë së Veriut

Në çështjen Joldeshi kundër Maqedonisë së Veriut¹⁷, GjEDNJ shqyrtoi shkeljen e parimeve themelore të procesit të drejtë në kuadrin e arrestimit paraprak. I pandehuri u mbajt në arrest “pa një vendim formal për një periudhë të zgjeruar”, duke cenuar garancitë e Nenit 5 dhe 6 të Konventës. Në këtë rast GjEDNJ konstatoi dy shkelje, edhe atë kohëzgjatja e paarsyeshme e arrestimit paraprak¹⁸, pasi i pandehuri i mbajt në arrest pa ndonjë vendim gjyqësor për më shumë se katër muaj, duke e kaluar kufirin e “kohës së arsyeshme” të paraparë me Konventë. Po ashtu, kishte shkelje edhe sipas Nenit 5 paragrafi 3, i cili parasheh nevojën që çdo person i arrestuar të paraqitet para një gjykatësi brenda një afati të shkurtër kohor dhe të mos mbahet në arrest pa një bazë ligjore të qëndrueshme.

Ndërsa sa i përket shkeljes së Nenit 6, këtu kemi mosrespektim të parimit të “çështjes së arsyeshme”, pasi kohëzgjatja e procedurave penale dhe

¹³ *Gashi and Kokollari v. North Macedonia*, Appl. no. 1706/18, ECtHR Judgment (2018).

¹⁴ *Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights*, ECtHR, 2022.

¹⁵ Neni 6(3) - E drejta për mbrojtje efektive.

¹⁶ *Action Plan of North Macedonia for ECtHR judgments*, 2019.

¹⁷ *Joldeshi v. North Macedonia**, Appl. no. 59215/16, ECtHR Judgment (2017).

¹⁸ Shkelje e nenit 5 paragrafi 3 të Konventës.

mosofrimi i një procesi të shpejtë cenuan të drejtën e të pandehurit për një gjyq të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Gjykata gjeti se sistemi juridik i Maqedonisë së Veriut nuk siguroi mjete efektive për të shpejtuar procesin dhe me këtë krijoi një precedent të rrezikshëm për të drejtat e personave të arrestuar.

Ky vendim i GjEDNJ solli dy pasoja të rëndësishme edhe atë, dëmshpërblim financiar për ankuesin sipas nenit 41 të Konventës, si dhe detyrimin e shtetit për reforma në sistemin e arrestimeve, duke paraparë vendosjen e kufizimeve strikte për kohëzgjatjen e arrestimit paraprak¹⁹.

Rasti “Joldeshi” vuri në spikamë problemet serioze në sistemin e drejtësisë penale në Maqedoninë e Veriut, posaçërisht për abuzimet në arrestimin paraprak dhe mos respektimin e parimit të proporcionalitetit. Ky rast ishte një alarm për vendin për ndërmarrjen e reformave serioze strukturore për respektimin e standardeve evropiane.

Conclusion

The analysis of the implementation of Article 6 of the European Convention on Human Rights (ECHR) reveals that the principle of a fair trial faces significant challenges in many member states, particularly those with weak traditions of judicial independence and procedural efficiency.

The European Court of Human Rights (ECtHR) has played a crucial role in monitoring and enforcing these standards through its binding rulings.

The case of North Macedonia before the Strasbourg Court demonstrates repeated violations of Article 6, primarily concerning excessive trial delays, lack of judicial independence, and ineffective legal safeguards. The ECtHR’s judgments have influenced reforms in three key directions: Financial compensation for victims of judicial misconduct; Legislative changes to expedite proceedings and ensure judicial independence; and International pressure to enhance transparency and accountability in the justice system.

Despite these interventions, the impact of judicial reforms in North Macedonia remains hindered by a lack of political will. While authorities rhetorically commit to reforms and international standards, persistent violations documented by the ECtHR particularly regarding access to a fair trial reveal systemic shortcomings. Nevertheless, the Strasbourg Court has served as a critical catalyst for legal changes, though challenges endure, especially in combating corruption and external influences on courts.

Ultimately, Article 6 remains the cornerstone of procedural and judicial rights protection in Europe. The ECtHR’s jurisprudence has consolidated high standards of procedural justice, compelling states to reform their legal systems. These rulings are not merely punitive but also guiding, shaping reforms toward effective human rights protection. While the ECtHR has the power to

¹⁹ Action Plan of North Macedonia on Execution of ECtHR Judgments, 2018.

obligate compliance, sustainable success depends on domestic systems' capacity to implement lasting reforms. The case of North Macedonia illustrates that the Strasbourg Court's influence is visible but insufficient alone a holistic approach is needed, combining institutional support, judicial empowerment, and public awareness to entrench the rule of law.

Recensentë:

Prof. dr. Qebir Avziu

Prof. dr. Ferat Polisi

Literatura e shfrytëzuar:

- Smith R and Anker Ch, *The Essentials of Human Rights*, Hodder Arnold, 2005
- Траењето на граѓанските и кривичните постапки во судската практика на Европскиот суд за човекови права, Досие за човекови права бр. 16, Совет на Европа, 2007.
- Роер Алин, *Совет на Европа*, Council of Europe Pub, (2010)
- *Council of Europe*, "Court system reformed after justice delayed for over a decade", *Impact of the European Convention on Human Rights – North Macedonia*, 2024
- *Council of Europe*, *European Court of Human Rights*, "Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights – Right to a fair trial (civil limb)", Strasbourg, 2024
- Gashi and Kokollari v. North Macedonia, Appl. no. 1706/18, ECtHR (2018).
- Joldeshi v. North Macedonia, Appl. no. 59215/16, ECtHR (2017).
- *Guide on Article 6 of the European Convention on Human Rights*, ECtHR, 2022, f. 12-15.
- *Doorson v. the Netherlands*, Appl. no. 20524/92, ECtHR Judgment (1996), f.72-76
- Action Plan of North Macedonia on Execution of ECtHR Judgments, 2018, f. 12-14
- *Action Plan of North Macedonia for ECtHR judgments*, 2019, f. 5-7.
- Action Plan of North Macedonia on ECtHR Judgments, 2020.
- Harris et al., *Law of the European Convention on Human Rights* (2022), Kapitulli 6.
- *Annual Reports of the European Commission for Democracy through Law (Venice Commission)* (për reformat në Maqedoninë e Veriut).
- Joldeshi v. North Macedonia, Appl. no. 59215/16, ECtHR Judgment (2017), f.28-35.

- Guide on Article 5 of the European Convention on Human Rights, ECtHR, 2021, f. 8-10. Buzadji v. Moldova, Appl. no. 23755/07, ECtHR Judgment (2016), f.104
- Van Dijk et al., Theory and Practice of the European Convention on Human Rights (2018).
- Reports of the Venice Commission on Judicial Reforms in North Macedonia (2019-2023).
- ECHR Statistics for 2023, <https://www.echr.coe.int/d/stats-annual-2023-eng?>